

NDËRMARRËSIA DHE EDUKIMI FINANCIAR

Tipi i Programit: Themelor

Historiku i Programit

Zhvillimi i këtij programi trajnues është ideuar duke u nisur nga Korniza Kurrikulare e Arsimit Parauniversitar të Kosovës (Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, 2016) në Shk 5 dhe Shk 6 - për gjimnaze, e cila përfshinë konceptet e TIK-ut, këshillimin dhe orientimin në karrierë, ndërmarrësinë dhe edukimin për zhvillimin e qëndrueshëm, kurse tek shkollat profesionale përfshihet edhe Teoria dhe praktika në profesion (varësisht nga profili arsimor).

Programi trajnues 'Ndërmarrësia dhe edukimi financiar', është konceptuar në konsultim të vazhdueshëm me personat përgjegjës për kurrikulën e fushës 'jeta dhe puna' në MASHT, ku si pikënisje fillestare ka qenë nevoja për zhvillimin profesional të mësimitdhënësve të kësaj fushe, si mbështetje e drejtëpërdrejtë e reformës kurrikulare. Kjo fushë mban në vete tri koncepte kryesore, ndërmarrësinë, orientimin dhe këshillimin për karrierë, dhe, Teknologjinë e informacionit dhe të komunikimit. Në bashkëpunim me zyrtarët përgjegjës për trajnime në MASHT, është menduar të përgatitet një pako trajnuese për mësimitdhënësit e kësaj fushe, e cila përmban të tri konceptet kurrikulare. Fillimisht, secili program trajnues do të hartohet dhe pilotohet veçmas, para se të grupohen në pakon prej tre programeve të kësaj fushe kurrikulare.

Pas aprovimit të parë të këtij kursi, janë trajnuar një numër i konsiderueshëm i mësimitdhënësve, ndërsa janë certifikuar me sukses 85 mësimitdhënës të gjimnazeve. Disa prej tyre janë edhe fasilitues shkollor edhe për kurset e tjera, si MBP dhe VpN, prandaj mund të ofrojnë me sukses edhe këtë kurs për kolegët e tyre në të ardhmen.

Gjatë vitit të parë të ASSET-it, janë hartuar dhe pilotuar dy nga tri programet e përmendura

1. 'Ndërmarrësia dhe edukimi financiar', dhe
2. 'Orientimi dhe këshillimi për karrierë'.

Të dy programet trajnuese janë testuar me nga 50 pjesëmarrës secili, ndërsa në fillim të vitit të dytë janë rishikuar në bazë të feedbackut të mbledhur nga faza e pilotimit, dhe janë përgatitur për akreditim.

Qëllimet e programit:

Me përvetësimin e këtij programi pjesëmarrësit duhet të jenë në gjendje të:

- Njohin rolin e ndërmarrësisë në shoqërinë moderne;

- Demonstronjë shkathtësive themelore të ndërmarrësisë, proaktivitetit, ndërgjegjësimit dhe të qenit inovativ;
- Shfrytëzojnë mjete interaktive që ndihmon provokimin e të menduarit si ndërmarrës tek të rinjtë (lojrat, puna në terren, diskutimet, prezantimet);
- Aplikojnë raste të studimit apo videove gjatë mësimin të ndërmarrësisë;
- Nxisin kreativitetin dhe zgjedhjen e problemeve përmes projekteve në ndërmarrësi;
- Përdorin metoda të thjeshta për të mësuar rreth pritjeve të klientëve për produktet apo shërbimet e ofruara në ndërmarrësi;
- Aplikojnë plane të thjeshta financiare.

Përmbajtja:

Ky program është pjesë e pakos së trajnimit për mësimdhënësit e fushës mësimore 'Jeta dhe puna', e cila përfshinë në vete tri koncepte kryesore: Ndërmarrësinë, Orientimin dhe këshillimin për karrierë, dhe Teknologjinë e informimit dhe komunikimit. Ky program trajnues i adreson konceptet e ndërmarrësisë dhe edukimit bazik financiar, dhe paraqet një të tretën e materialit që pritet të realizohet nga fusha 'jeta dhe puna' (pjesa për 'Orientim dhe këshillim në karrierë' dhe 'Teknologjinë e informacionit', janë programe të veçanta trajnimi). Përmes trajnimit të mësimdhënësve në këtë program fillimisht do të afektohen të gjithë nxënësit e shkollave partnere të Programit, të cilët duke qenë të mentoruar nga mësimdhënësit e trajnuar, si rezultat do të themelojnë ndërmarrjet e tyre ushtrimore në shkollë. Edhe pse i dizajnuar për mësimdhënësit e fushës 'jeta dhe puna', ky program është i përshtatshëm poashtu si trajnim plotësues për mësimdhënësit e fushave tjera të këtij niveli të shkollimit. Përgjatë këtij trajnimi pjesëmarrësit do të kuptojnë thelbin e mjeteve për të krijuar shkathtësi ndërmarrëse tek nxënësit e tyre. Ata do të pajisen me udhëzime rreth të mësuart të kompetencave thelbësore të ndërmarrësisë duke përfshirë këtu planifikimin e biznesit, administrimin, marketingun, menaxhimin e burimeve njerëzore si dhe menaxhimin e projekteve.

Grupi i synuar

Të gjithë mësimdhënësit e fushës 'jeta dhe puna' të shkollave të mesme të larta, Gjinnazeve dhe shkollave profesionale, respektivisht klasave X, XI, dhe XII. Numri i tyre mund të arrijë 600, për të cilët ky program trajnimi do të duhej të ishte themelor sa i përket licencimit të tyre. Por, ky program poashtu është i përshtatshëm edhe për mësimdhënësit e fushave tjera mësimore të këtij niveli të shkollimit, si trajnim plotësues, numri i të cilëve nuk është i kufizuar.

Pas ri-aprovimit të kursit ka mundësi të organizohen nga 4 grupe gjatë vitit shkollor, por kjo varet nga interesimi i Ministrisë, DKAve dhe shkollave. Potencialisht janë edhe rreth 500 mësimdhënës që kanë nevojë të trajnohen me këtë program.

Forma e organizimit /Kohëzgjatja

Pjesëmarrësit e identifikuar paraprakisht do të marrin detyrat përgatitore duke pranuar materialin për lexim fillestar. Pastaj, pjesëmarrësit do të vijojnë tri ditë të plota, secila ditë me nga katër sesione 90 minutëshe, të moderuara nga fasilituesit profesional. Ndërmjet ditëve të trajnimit do të ketë hapësirë kohore prej disa javësh, për të zbatuar aktivitet me nxënësit e tyre, dhe gjatë kësaj periudhe do të mentorohen nga fasilituesit e programit, që të mbështeten në përbushjen e kërkesave për certifikim.

Gjithsejt programi organizohet me gjithsejt 24 orë angazhim kohor:

6 orë x 3 ditë= 18 orë kontaktuese

6 orë për implementimin e aktiviteteve dhe pjesëmarrjes në takimet reflektuese (përgatitje, konsultime online, observime në klasë, etj.)

Vlerësimi/Certifikimi

Në fund të këtij trajnimi pjesëmarrësit mësimdhënë do të certifikohen duke u kredituar me gjithsejt 24 orë të plota trajnimi.

Kriteret për certifikim janë:

- 90% pjesëmarrje në trajnim dhe në takimet reflektuese me mentor;
- Portfolio që dëshmon se janë zbatuar aktivitetet në klasë me nxënësit (me së paku 5 plane mësimore të lidhura me rezultatet mësimore / apo një projekt mësimor); [për mësimdhënësit e fushave tjera mësimore (përveç 'jeta dhe puna') janë të mjaftueshme 2 plane mësimore];
- Themelimi i firmës virtuale ose reale të nxënësve të shkollës.

Materialet e trajnimit

- Udhëzuesi për fasilitues të programit trajnues;
- Sllajdet në Power Point / Video prezentimet;
- Dokumenti "Entrepreneurship Learning Toolkit" (nga MASHT dhe Kultur Kontakt Austria);
- 'Jeta dhe puna' – Doracak për mësimdhënësit të gjimnazëve.